



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226419
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05853240

C-IV.-14-7208

Ankuesi:

E H nga fsh. G, Komuna Ferizaj, i përfaqësuar nga B I avokat Prishtinë.

Kundër

E paditura:

N.SH “Bankos”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit-Autoriteti i Likuidimit (AL), rruga “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakërishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), sipas gjyqtarit, Dr.sc.Murat Hulaj, me dt.24 qershor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankuesit, dhe **VËRTETOHET**, vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.PRN125-0024 i dt.21 tetor 2014.
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt. 27 nëntor 2014, ankuesi përmes përfaqësuar nga autorizuarit B I avokat nga Prishtina parashtron ankesë ne DHPGJS, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN125-0024 te dt. 21 tetor 2014, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme, kërkesa për kompensim për paga të pa paguara për periudhën prej 01.03.2000 deri me dt. 08.08.2001. në shumë prej 1,800.00€ nga NSH “Banka Themelore e Kosovës ” (në likuidim). Ankuesi e paraqet ankesën për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale për me shumë si ne përmbajtjen e ankesës se përpiluar me dt. 24 nëntor 2014, e shoqëruar me bashkëngjitje te provave vijuese:

- Vendimi mbi ndërprerjen e mardhënje se punës.
- Letërnjoftimi;
- Kopja e vërtetimit të përvojës së punës;
- Aktvendimi për caktimin e konotacionit të të ardhurave personale;
- Vendimi mbi themelimin e marrëdhënies se punës;
- Caktim të përkohshëm në vendin e punës;
- Vendimi i AL-ës;
- Vendimi i AL-ës;
- Aktvendimi i Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme SCA-07-0042, duke i propozuar Dhomës se Posaçme që pas analizimit dhe administrimit të provave në shkresë të lëndës e në përputhje me nenin 70 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të bie:

AKTGJYKIM

- Miratohet në tersi ankesa e ankuesit si e bazuar dhe të anulohet vendimi i AL-ës nr. PRN125-0024 të NSH Bankos (në likuidim) si e pa bazuar.
- Obligohet AL-ja i NSH-ës Bankos (në likuidim) që të bëjë kompensimin e pagave të papaguar, në vlerë prej 8,000.00 Euro
- Obligohet AL-ja i NSH-ës Bankos (në likuidim) që të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të tarifës së odes së avokatëve të Kosovës, për hartimin e kësaj ankese në vlerë prej 104.00 euro si dhe të gjitha shpenzimeve tjera deri në fund të procedurës.

E paditura AKP-ja, ka parashtruar mbrojtjen-përgjigje ndaj ankesës së paditësit, me dt. 27 qershor 2023, e cila në DHPGJS është pranuar dhe regjistruar me dt. 30 qershor 2023, duke dhënë përgjigje- në ankesën e paditësit, ku e paditura ka pohuar se vendimi i AL nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe se AL-ja ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore në fuqi janë zbatuar drejtë. Konsideron se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të kundërshtuar. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur AL-ja me vendimin e saj dhe nuk ka ofruar asnjë argument ligjor. Ka kërkuar që në bazë të dispozitave ligjore, gjykata ta refuzoj ankesën e ankuesit.

Me dt.23 shkurt 2024, gjykata përmes urdhrit, ka kërkuar nga i autorizuari i ankuesit, që të bëjë dorëzimin e provave shtesë dhe atë: kopjen e librezës së punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, provën me të cilën dëshkohet se NSH, i ka mbetur borxh paga të pa paguara, listën e pagave me të cilën dëshkohet se i njëjti ka pranuar paga nga NSH. si dhe si dhe prova tjera që dëshmojnë pretendime ankimore.

I autorizuari i paditësit përkundër asaj që është njoftuar me Urdhrin për provat e kërkuara nga gjykata **nuk i është përgjigjur urdhrit të dt.23 shkurt 2024**, për sigurimin e të njëjtave dhe as që ka paraqitur ndonjë arsyeshmëri për mos sigurimin e të njëjtave.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL PRN125-0024 te dt. 21 tetor 2014.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1, pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3, të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2, e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtore e NSH-së, por nga shkresat e lëndës, gjykata vij në përfundim, se, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për paga të pa paguara për periudhën sa kishin qenë duke punuar dhe atë sipas specifikimit -kërkesës se vetë paditësit qe kishte marrë nj vendim Refuzimi nga vetë AL të AKP-së, ku për këtë vetë paditësi kishte shprehur pakënaqësie dhe ju kishte drejtuar DHPGJS me ankesë, mirëpo pa bashkangjitur prova relevante për ta bërë te besueshme ankesën për te vendosur ndryshe.

Me qëllim të të provuarit për gjetjen e se vërtetës, e meqë në shkresa të lëndës mungonin provat e duhura te parashtruar nga paditësi, gjykata përmes një Urdhëri me dt.23 shkurt 2024 nga i autorizuari i paditësit ka kërkuar plotësimin e provave dhe atë: kopjen e librezës së punës; njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës; provën me te cilën dëshmohet se NSH, i ka mbetur borxh paga te pa paguara; listën e pagave me të cilën dëshmohet se i njëjti ka pranuar paga nga NSH; si dhe si dhe prova tjera që dëshmojnë pretendime ankimore., paditësi ka dështuar ti paraqes ne gjykatë edhe pse provat bien mbi barrën e te provuarit nga palët gjykata si dhe Specifikacion për pagat e pa paguara për periudhën e kërkuar përkatësisht shumen e kërkuar. Ankuesja ka dështuar që të dorëzojnë prova relevante në mbështetje të ankesës së saj edhe pas parashtrimit të ankesës në DHPGJS.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të saj ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se sa është shuma të cilën i ka mbetur borxhe paditura. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara për periudhën e padefinuar nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pa bazuara

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1, dhe 74 par.4, të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kërkesa e palës paditëse për shpenzimet e kërkuar nuk është miratua bazua në atë se padia ju ka refuzua si e pa bazë dhe se vendimi i AL-AKP-ës, PRN125-0024 të dt. 21 tetor 2014, është Vërtetu. Sikurse AKP-eja të kishë kërkuar shpenzimet e bazë në efektin e këtij Aktgjykimi Refuzues-përkatësisht vërtetues në raport me AL, gjykata detyrimisht ishte dashur ta aplikoj dispozitën e nenit 62 par.2 të Ligji nr. 06/l-086 për Dhomën e Posaçme të Gyrates Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit për ta detyru paditësin për përmbushjen e shpenzimeve procedural, e jo në rastin konkret të ja njëjshëm shpenzimet e kërkuar në padi pasi që aktgjykimi i sjellur nuk ka prodhu efekt për palen paditëse.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi, mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme, brenda 15 ditëve, nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r,
Dr.sc. Murat Hulaj,
